

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-T

Data: 2 maj 2012

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Kryegjykatës
Gjykatësit Burton Hall
Gjykatësit Guy Delvoie

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 2 maj 2012

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**URDHËR PËR LIRIMIN E ZORAN STIJOVIQIT NGA STATUSI I
DËSHMITARIT**

Zyrës së Prokurorit

Z. Paul Rogers

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen M. Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE (“Dhoma”) e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”);

DUKE MARRË SHËNIM se më 24 dhe 25 gusht 2011, z. Zoran Stijoviq (“dëshmitari”) dëshmoi para Dhomës;

DUKE MARRË SHËNIM se më 24 dhe 25 gusht 2011, Balaj dhe Brahimaj rezervuan të drejtën për t’i bërë pyetje dëshmitarit dhe shprehën qëndrimin se mund t’a thërrasin për pyetje në një fazë të mëvonshme;¹

DUKE MARRË SHËNIM se më 25 gusht 2011, Kryegjykatësi i Dhomës e informoi z. Stijoviq se ai kishte ende statusin e dëshmitarit dhe se nuk duhej të diskutonte me askënd dëshminë e tij, sidomos me anëtarë të Zyrës së Prokurorisë (“Prokuroria”) derisa të lirohet përfundimisht nga statusi i tij si dëshmitar;²

DUKE MARRË SHËNIM se më 20 mars 2012, Dhoma u kërkoi jozyrtarisht të Akuzuarve që të bënin të ditur nëse ende synojnë ta thërrasin dëshmitarin për pyetje;

DUKE MARRË SHËNIM se më 20 prill 2012, Prokuroria përfundoi me paraqitjen e provave;³

DUKE MARRË SHËNIM se më 25 prill 2012 dhe 26 prill 2012, avokatët e Balajt dhe Brahimajt informuan jozyrtarisht Dhomën se ata nuk kanë synim t’a thërrasin dëshmitarin për pyetje të tjera;

DUKE MARRË SHËNIM qëndrimet e shprehura nga Balaj dhe Brahimaj gjatë Konferencës për Gjendjen të 2 majit 2013 se ata nuk kanë më nevojë për praninë e dëshmitarit për pyetje;⁴

¹ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda nr. IT-04-84bis-T, T. 511, 594-595.

² Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda nr. IT-04-84bis-T, T. 623-624.

³ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda nr. IT-04-84bis-T, T. 2715.

BAZUAR NË Rregullën 54 të Rregullores së Procedurës dhe Provave

URDHËRON që dëshmitari të lirohet prej statusit si dëshmitar.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Bakone Justice Moloto
Kryegjykatës

Sot, më datën 2 maj 2012.
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

⁴ Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda nr. IT-04-84bis-T, T. 2735.